

**VENDIM****Nr. 10, datë 10.3.2016**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 1, DATË 4.2.2016, TË KOMITETIT
PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE, DHE
PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT
PËR PROJEKTE TË GRANTIT
“INFRASTRUKTURA VENDORE DHE
RAJONALE”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT
VENDOR DHE RAJONAL, SHTYLLA I,
THIRRJA I, PËR VITIN 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhë vendimit nr. 1, datë 4.2.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për përcaktimin e buxhetit e të drejtimeve prioritare të fondit për zhvillimin e rajoneve dhe kalendarit të programeve të financimit, për vitin 2016”, bëhet një ndryshim, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpërndarjen e fondeve për projekte të reja për grantin “Infrastruktura Vendore dhe Rajonale”, Programi i Zhvillimit Vendor dhe Rajonal, shtylla I, thirrja I, sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për t’u financuar, sipas pikës 2 të këtij vendimi, brenda tri javëve nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit e përdorimit të fondeve, si dhe emrin e personit përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të punimeve.

4. Autoritetet kontraktuese për projektet, sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të kryejnë

procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit deri në fillim të tremujorit të dytë të vitit 2016. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t’i rishpërndajë ato.

5. Ngarkohet sekretariati teknik në Ministrinë e Zhvillimit Urban të kryejë monitorimin dhe raportimin e ecurisë së zbatimit të projekteve, pranë Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve përmes Sekretariatit të Përgjithshëm, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 3 të këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYETARI
Niko Peleshi**

Zëvendëskryeminstri
Ministri i Financave
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Ministri i Zhvillimit Urban
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës
Ministri i Arsimit dhe Sportit
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe
Administrimit të Ujërave
Ministri i Shëndetësisë
Ministri i Kulturës
Ministri i Mjedisit
Ministri i Punëve të Brendshme
Ministri i Shtetit për Inovacionin
dhe Administratën Publike
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4

Zëvendëskryetar
anëtar;

anëtar
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar;

anëtar;

anëtar;
anëtar;
anëtar.



Tabela 4. Ndryshim në tabelën 2, që i bashkëlidhë vendimit nr.1, datë 4.2.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Thirrja	Data	Shtylla/Programi/Granti	Projekte	Vlera e grantit për thirrje
Thirrja I	4 Shkurt 2016	Shtylla 1 - Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale - Granti 1: Infrastruktura vendore dhe Rajonale	Projekte që shërbejnë si katalizator i rivitalizimit të qytetit, përmes jetëzimit të hapësirave publike e të ekonomive lokale, përmirësimit të aksesit e të lëvizshmërisë, rivitalizimit të poliëndrave urbane dhe të përmirësimit të infrastrukturës vendore, përmirësimit të cilësisë së jetës.	3,900,000,000

Shënim:

- Rritja e vlerës së grantit për financimin e projekteve të thirrjes 1, të grantit për infrastrukturën vendore dhe rajonale, është përfutur nga:
 - fondi i krijuar nga diferenca midis vlerave të projekteve të miratuara në vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe vlerave të kontratave, pas lidhjes së kontratës, për projektet me cikël financimi 2015-2016, të grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale,
 - fondi i krijuar nga diferenca midis vlerave të projekteve të miratuara në vendimet e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve dhe vlerave të kontratave, pas lidhjes së kontratave, për projektet me cikël financimi 2015-2016, të grantit të Shqipërisë Dixhitale, si dhe,
 - nga fondi i dy projekteve të anuluar në programin Shqipëria Dixhitale, sipas Vendimit Nr.11 të KZHR, datë 10.3.2016.





Tabela 1. Lista e projekte të reja për financim nga FZHR 2016, përmes grantit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e Financimit për vitin 2016 (Lekë)	Vlera e Financimit për vitin 2017 (Lekë)
QARKU BERAT					
1	Bashkia Berat	Rikualifikim dhe rikonstruksion i rrugeve "Stadiumi i vjetër- Stadiumi i ri", rruga "Stadiumi, rruga "Koli Vesho dhe sheshi para Stadiumit	299,965,989	149,982,995	149,982,995
2	Bashkia Ura Vajguore	Rehabilitimi urban i zones përgjatë lumit Osum, Loti 1	179,989,500	89,994,750	89,994,750
3	Bashkia Polican	Rehabilitimi i shëtitorës Miqësia	27,546,411	13,773,206	13,773,206
4	Bashkia Skrapar	Rikualifikimi i hapësirave përreth pallatit të kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja "Pasha Hysi", rruga automobilistike "Pasha Hysi"	265,427,536	132,713,768	132,713,768
QARKU GJIROKASTER					
5	Bashkia Gjirokastrë	Rikonstruksion i hapësirave publike dhe rrugës hyrëse pranë Memorialit të Rilindasve në Gjirokastrë	99,755,007	49,877,504	49,877,504
6	Bashkia Këlcyre	Rikualifikim urban përreth përroit në lagjen "Gur" si edhe sistemim i shtratit të përroit	67,810,604	33,905,302	33,905,302
7	Bashkia Memaliaj	Projekti i Ansambllit Arkitektonik të sheshit Minatori, Memaliaj	151,350,288	75,675,144	75,675,144
8	Bashkia Delvine	Rijetesimi i qendres së Delvines	133,465,176	66,732,588	66,732,588
QARKU DURRËS					
9	Bashkia Durrës	Rivitalizimi i sheshit publik para hyrjes së portit	585,000,535	292,500,268	292,500,268
10	Bashkia Kruje	Zgjerim i rruges hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendres së qytetit	366,281,871	183,140,936	183,140,936
QARKU KUKES					
11	Bashkia Has	Rehabilitimi i godinave, shesheve dhe qendrës së qytetit Krumë-Has	106,997,427	53,498,714	53,498,714
12	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Bajram Curri - Vernice	65,376,393	32,688,197	32,688,197
QARKU SHKODER					
13	Bashkia Malesi e Madhe	Rehabilitim i Qendres së qytetit Koplik	208,796,331	104,398,166	104,398,166
14	Bashkia Puke	Sistemim i lagjes pas pallatit të kultures	28,390,307	14,195,154	14,195,154
15	Bashkia Shkoder	Rikonstruksion i Bllokut të pallateve "Xhabije"	76,654,597	38,327,299	38,327,299
QARKU LEZHE					
16	Bashkia Lezhe	Lulishte dhe parkimi perballë gjimnazit "Hydajet Lezha", lagje "Beselidhje"	25,200,932	12,600,466	12,600,466
17	Bashkia Mirdita	Rikualifikimi urban i sheshit të qytetit Rreshen	186,901,843	93,450,922	93,450,922
QARKU FIER					
18	Bashkia Patos	Shetitore " Republika"	98,615,048	49,307,524	49,307,524
19	Bashkia Patos	Ndertimi i rruges Ruzhdie - Gjinoqar	66,213,456	33,106,728	33,106,728
20	Bashkia Fier	Ndertim i parkut qendror të qytetit, rehabilitim i rruges Xoxi Andoni dhe hapësirat rreth saj	300,126,792	150,063,396	150,063,396
21	Bashkia Fier	Rivitalizim i parkut pranë bar Rinise dhe rehabilitim i rruges Dervish Hekali	147,498,882	73,749,441	73,749,441
22	Bashkia Lushnje	Rotondo e Plugut-Postobllok, rruga e	106,224,781	53,112,391	53,112,391



		hyrjes Lushnje-Tirane, (faza e dytë)			
23	Bashkia Divjake	Segmenti 3 i Pasareles+Ure ne dru pergjate rruges automobilistike, Hyrje Parkut-Godulla e Brendeshme	102,130,235	51,065,118	51,065,118
		QARKU VLORE			
24	Bashkia Sarande	Rikonceptim dhe rivitalizim i qendres se qytetit Sarande, Rruga e flamurit	105,643,979	52,821,990	52,821,990
25	Bashkia Himare	Rikualifikim urban i sheshit Borsh	26,467,315	13,233,658	13,233,658
26	Bashkia Himare	Rikualifikim urban i sheshit Lukove	89,461,945	44,730,973	44,730,973
27	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim asfaltim i rrugës së Unazës Vlorë (Poliklinka 7 Pallatet)	582,999,971	291,499,986	291,499,986
		QARKU KORCE			
28	Bashkia Maliq	Rehabilitim rruga hyrese " Pylli i Fazaneve"	28,071,408	14,035,704	14,035,704
29	Bashkia Devoll	Rikualifikim urban i qendres se Qytetit Bilisht, Loti 1	124,315,222	62,157,611	62,157,611
30	Bashkia Korce	Restaurimi i objekteve te pazarit Korce Lote 2	167,166,000	83,583,000	83,583,000
31	Bashkia Kolonje	Rikonstruksioni i rrugeve dhe fasadave të shehsit "Rilindja " Erseke	51,858,597	25,929,299	25,929,299
32	Bashkia Korce	Rikonstruksion i qendres dhe infrastruktures rrugore dhe monumenteve te kultures, Voskopoje	370,000,000	185,000,000	185,000,000
		QARKU TIRANE			
33	Bashkia Kavaje	Rehabilitimi i përroit Leshniqe, Kavajë	450,000,000	225,000,000	225,000,000
34	Bashkia Tiranë	Rikualifikim urban i bllokut nr.1 (Lapraka), kufizuar me rrugët "Don Bosko"- Shinat e Trenit (Filanto)-"Turhan Pashë Përmeti"- "Ibrahim Pashë Bushatliu"- "Lord Bajron"- "Riza Cuka"- "Learton Vathi"- "Pandi Dardha"- "Dritan Hoxha".	412,523,232	206,261,616	206,261,616
35	Bashkia Tiranë	Rikualifikimi urban i rrugëve në bllokut e pallateve "Selitë", njësia administrative nr.5	135,492,330	67,746,165	67,746,165
		QARKU DIBER			
36	Bashkia Diber	Rinovim i infrastruktures se bulevardit "Elez isufi", rruges "Safet Zhulali" dhe rruges se "Muzeut"	110,726,698	55,363,349	55,363,349
37	Bashkia Diber	Permiresimi i infrastruktures vendore dhe rivitalizim i hapësirave publike ne zonen prane Pallatit te kultures	207,649,090	103,824,545	103,824,545
		QARKU ELBASAN			
38	Bashkia Prrrenjas	Ndërtim trotuari përgjatë rrugës Nacionale (ndriçim, gjelbërim, etj)	81,826,086	40,913,043	40,913,043
39	Bashkia Gramsh	Sistemim asfaltim i bllokut te banimit ne lagjen Sporti 2	87,703,359	43,851,680	43,851,680
40	Bashkia Peqin	Ura e fshatit Grykesh, te Njesia Administrative Pajove, bashkia Peqin	3,840,680	1,920,340	1,920,340
41	Bashkia Elbasan	Rikonstruksion i rruges rurale Qaf Hajdaran - Byshek	183,168,845	91,584,423	91,584,423
42	Bashkia Elbasan	Sistemim Asfaltim i rruges "28 Nentori"	194,988,741	97,494,371	97,494,371
43	Bashkia Belsh	Projekti i Ansamblit Rilindja, Belsh	180,801,690	90,400,845	90,400,845
44	Bashkia Librazhd	Rikualifikim urban i bllokut te banimit nr.1	133,764,056	66,882,028	66,882,028
45	Bashkia Librazhd	Rikualifikim urban i zones ne hyrje te qytetit dhe mbrojtje lumore	99,835,297	49,917,649	49,917,649
		TOTALI	7,524,024,482	3,762,012,241	3,762,012,241

Shënim:

1. “Vlera e plotë e projektit” përfaqëson vlerën brenda së cilës caktohet fondi limit për prokurimin e zbatimit të punimeve (kur nuk ka financim tjetër nga autoritetet kontraktuese). Vlera e plotë e projektit përcillet nga sekretariati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).
2. “Vlera e financimit për vitin 2016” tregon vlerën e financimit që vihet në dispozicion nga buxheti i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016.
3. Diferenca financimit të vlerës së plotë (mbas prokurimit) me vlerën e financimit për vitin 2016 do të financohet nga FZHR-ja për vitin 2017.
4. Për projektet e financuara më sipër, të cilat gjejnë zbatim pranë strukturave ujore, dhe/ose lumenjve, dhe/ose përrenjve, autoritetet kontraktuese duhet të konsultohen për zbatimin e projektit me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës.
5. Për projektet e financuara më sipër, ku do të ndërhyhet në zona me rëndësi për trashëgiminë kulturore, autoritetet kontraktuese do të zbatojnë projektet në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, në përputhje me ligjin nr.9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”.

